

# AKT THEMELUES

## I SHOQERISE TREGTARE PRIVATE

**“GEO \_MET ALBANIA” SH.P.K.**

Unë Lura Demiri, e bija e Hiqmetit, dtl 26.04.1980, banues ne Rr Myslym Shyri ,pll 124/2 Shk. 2, Ap 21, Tirane

Mbështetur në Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit ” dhe në Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ”, sot më datë 04.11.2021, krijojme shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar “GEO \_MET ALBANIA ” , me aktin themelues të saj si vijon :

### FORMIMI

NENI 1

Formohet shoqëria private e quajtur “GEO \_MET ALBANIA” sh.p.k. Shoqëria do ti nënshtrohet legjislacionit shqiptar, ndërsa degët që mund të krijohen do ti nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë dega.

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortaku themelues.

### SELIA E SHOQERISE

NENI 2

Selia e shoqërise tregtare private “GEO \_MET ALBANIA” sh.p.k. do të jetë :  
Njesia bashkiake Nr 10, Rruga Myslym Shyri, Pallati nr 124/2, Shk 2 Ap 21,Tirane  
Ajo mund te çelë dhe seli të tjera të dyta, degë e filiale, përfaqësi dhe agjenci oprative në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe me miratim të organve kompetente edhe jashtë vendit.



Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, dege, të krijojë filiale si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendimin e ortakut themelues të saj.

### OBJEKTI I VEPRIMTARISE

#### NENI 3

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në fushat si me poshtë:

1. Punime Topo-Gjeodezike te te gjitha llojeve
2. Ekspertiza Topo-Gjeodezike per individe dhe per Gjykatat dhe Prokurorit e Republikës se Shqiperise
3. Vleresime te pasurive te paluajteshme dhe te luajteshme per llogari te bankave, zyrave permbarimore dhe individeve
4. Studime dhe projekte mbi masat e mbrojtjes nga zjarri te ndertesave te cdo lloji
5. Arte pamore-dekor (Piktura Murale) per ambiente te brendeshme dhe te jashteme per biznese dhe individe
6. Konsulta te ndryshme ne lidhje me pasurit e paluajteshme.

#### NENI 4

Për kryerjen e veprimtarisë së saj shoqëria do të sigurojë mjetet e nevojshme dhe do të bashkëpunojë me persona fizikë dhe juridikë, vendas dhe të huaj.


### KOHEZGJATJA E SHOQERISE

#### NENI 5

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar. Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkaku.

### KAPITALI I SHOQERISE

#### NENI 6



Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare private “GEO\_MET ALBANIA” sh.p.k. do të jetë **100.000** (Njeqind mijë) lekë dhe do të përbëhet nga kuotat e ortakeve themelues të shoqërisë. Kapitali përbëhet nga **1** kuota dhe vlera nominale e një kuote është e barabartë me **100 000** lekë. Znj. Lura Demiri zotron 1 kuote me vlerë 100 000 leke që perbene 100% te kapitalit themeltar

Kapitali themeltar fillestar mund të shtohet sipas vendimit të ortakeve themelues. Kapitali është tërësisht i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm.

#### NENI 7

Ortaku i vetëm duhet të bëjë përpjekje përritjen e potencialit ekonomik të shoqërisë, të ruajë sekretin e saj dhe të mos dëmtojë interesat e personave të tjera dhe të shoqërisë.

### DREJTIMI I SHOQERISE

#### NENI 8

Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj, Znj. Lura Demiri, e cila është përfaqësues ligjore i saj. Afati i emërimit të administratorit është për një periudhë kohore prej **5** vjet me të drejtë ripërtëritje.

#### NENI 9

Të ardhurat neto të shoqërisë i takojnë ortakut themelues të shoqërisë.


#### NENI 10

Ortaku themelues ka të drejtë të emërojë dhe administratorë të tjera të vlerave materiale të shoqërisë. Ai ka të drejtë të caktoje financier, likuidator për problemet e shoqërisë, si edhe të pajtojë persona të tjera si ortakë. Financieri nxjerr rregullisht treguesit financiare tre-mujore, 6-mujore dhe vjetore, për aktivitetin e kryer të shoqërisë.

#### NENI 11

Konfliktet që mund të lindin midis palëve do të gjykohen dhe zgjidhen në zbatim të legjisacionit shqiptar në gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

#### NENI 12

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Lura Demiri". It is enclosed in a circle and includes a small "v.v." at the end.

Shoqëria ka vulën e saj në madhësi të zakonshme, me tekstin për rrithin e saj.

NENI 13

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe veçanërisht të Ligjit **Nr. 9901** datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

NENI 14

Ky akt themelimi përpilohet në tre kopje me vlerë të barabartë, nga të cilat njëra depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit, njëra në zyrën e Tatimeve dhe kopja e tretë mbahet në dokumentat e shoqërisë tregtare

“GEO\_MET ALBANIA” sh.p.k.

Akti i themelimit nenshkruehet rregullisht nga ortaket themelues.

ORTAKU I VETEM THEMELUES I SHOQERISE

“GEO\_MET ALBANIA” sh.p.k

Lura Demiri

Lura Demiri  
